

KUD: 94(398.7) (093.2)
94(496.5) .016 / .062 (093.2)

Etleva LALA

ARKIVAT E PENITENCIERISË SË SHENJTË APOSTOLIKE DHE NJË RAST ABORTI NË PULTIN E POSHTËM

Penitenciera Apostolike (*Sacra Poenitentiaria Apostolica*) ishte institucioni më i lartë i hirit, mëshirës dhe faljes në mesjetën evropiane.¹ Ajo ishte një ndër tre postet më të rëndësishme të Kurisë Papnore, e cila krahas këtij institucioni përbëhej edhe nga Kancelaria Apostolike dhe Dhoma Apostolike. Penitenciera Apostolike ishte *par excellence* instrumenti me anë të të cilit papa shpërndante hir dhe falje ndër të gjithë besimtarët e krishterë të ritit latin pa asnjë lloj dallimi mes tyre. Ekzistenca dhe aktiviteti i kësaj zyre rridhte direkt nga autoriteti personal i vetë papës, nga e drejta që i rezervohej vetëm atij për të ushtruar supremaci në të gjitha çështjet e rregullit dhe të disiplinës që kishte lidhje si me jetën fetare ashtu edhe me atë të përditshme në të gjithë Evropën Perëndimore.

Falja e mëkateve ka qenë vazhdimisht pjesë përbërëse e Kishës Katolike si sistem, dhe shumë lloje mëkatesh faleshin nga hallka të ndryshme të këtij sistemi, duke filluar që nga prifti i thjeshtë. Megjithatë kishte mëkate apo krime që konsideroheshin kaq të rënda, saqë nuk lejohej të faleshin nga askush përveçse nga papa që kishte pushtet absolut në tokë. Rastet më të hershme kur papët filluan të rezervojnë faljen e besimtarëve vetëm te autoriteti i tyre privat, e drejtë kjo për të absolvuar mëkatarët nga disa lloj krimesh që në atë kohë konsideroheshin veçanërisht të rënda, vjen që prej shek. XII, dhe konkretisht nga Koncili i Dytë Lateran (1139).²

¹ Për më shumë në lidhje me Penitencierinë Apostolike shih Kirsi Salonen, *The Penitentiary as a Well of Grace in the Late Middle Ages: The Example of the Province of Uppsala 1448-1527*. vol. 313 (Academia Scientiarum Fennica, 2001). See also Kirsi Salonen and Ludwig Schmutge, *A Sip from the 'Well of Grace': Medieval Texts from the Apostolic Penitentiary* (Washington DC: Catholic University of America Press, 2009).

² Koncili i Dytë i Lateranit, mbajtur në Romë në vitin 1139, shpalli në kushtetutën e tij nr. 15, në

Rastet e para të rënda kanë të bëjnë kryesisht me dhunën e ushtruar ndaj priftërinjve, por pas këtij “mëkati të parë të rezervuar”, filloi procedura që edhe shumë shkelje të tjera të normave kishtare të rezervoheshin ekskluzivisht për autoritetin apostolik të vetë papës në fuqi.

Në fillim ishte vetë papa ai që i trajtonte me kujdes të gjitha rastet e parregullsiive, por duke qenë se bashkë me rritjen e autoritetit papnor në Evropë, u rrit edhe numri i atyre që kërkonin falje e shpengim nga parregullsitë në të cilat kishin rënë, papa ia delegoi pushtetin për t’i trajtuar raste të tilla njërit prej kardinalëve më të besuar të tij, që më vonë do të quhej penitenciar. Penitenciera e Shenjtë Apostolike filloi të funksiononte si institucion më vete që në shekullin XII. Fillimisht ky institucion operonte si një zyrë e brendshme papnore, që merrej me parregullsitë personale të anëtarëve të kurisë papnore, por kompetencat e saj u rritën shkallësisht, duke qenë se me kalimin e kohës, filluan që edhe mëkatarët jashtë oborrit papnor t’i drejtoheshin papës për falje dhe shpengim. Kështu zyra e penitencierisë u nda në zyrë të poshtëm (minore)³ dhe zyrë të madhe (majore), kjo e fundit e dizenuar për të gjykuar rastet e jokurjalëve.

Papa, si përfaqësues i Perëndisë në tokë, posedonte të gjitha pushtetin (*plenitudine potestatis*) e mundshëm në Evropën mesjetare, dhe sipas këtij pushteti ai mund të shpërndante lloje të ndryshme të të ashtuquajturës mëshirë ose hir, nëpërmjet Penitencierisë së Shenjtë. Absolucion i ishte forma e mëshirës që e çlironte mëkatarin nga dënimi që meritonte për krimet të rënda duke e falur atë. Papa kishte rezervuar një listë të krimeve të tilla ose të thyerjeve të rënda të normës dhe të rregullave të së Drejtës Kanonike që mund të faleshin vetëm nga papa, sigurisht nëpërmjet Penitencierisë Apostolike. Ekzistonin disa lloj faljesh që mund të kërkoheshin nga papa, respektivisht nga Penitenciera Apostolike. Nëse falja kërkohet vetëm për një rast, quhej dispensë. Nëse kërkohet leje e veçantë për t’u përjashtuar nga rregulli apo një ligj i caktuar, dokumenti quhej licencë. Mëkatarin, apo ai që kishte shkelur normën apo që kërkonte leje për një gjë të tillë, duhet të bënte një kërkesë për falje apo leje që quhej suplikë. Mëkatarin vetë që ia parashtronte kërkesën e tij Penitencierisë së Shenjtë, quhej petent.

kanonin e njohur si Si quis suadente diabolo, që të gjithë të krishterë që vepronin dhunshëm kundër një kleriku të merrnin çkishërim të menjëhershëm dhe automatik, nga i cili ata mund të shpengoheshin vetëm nga papa. *Shih Privilegium Canonici*
<https://www.newadvent.org/cathen/12437a.htm> (accessed in August 2022).

³ Filippo Tamburini, “Art. Penitentiaries, minor,” in *Encyclopedia of the Middle Ages*, vol. 2 (2000): 1112.

Detyra kryesore e Penitencierisë së Shenjtë Apostolike ishte të gjykonte kërkesat e atyre besimtarëve që në një mënyrë apo në një tjetër kishin shkelur normat religjioze kanonike, dhe eventualisht t'i falte ata. Në fillim, këtë lloj falje, në të shumtën e rasteve e kërkonin vetëm ata që dëshironin të fillonin apo të ruanin statusin e klerikut, duke kërkuar që të korrigjonin disa nga parregullsitë që i pengonin ata në këto lloj statusi, si p.sh. lindje e jashtëligjshme, defekte fizike etj., ose ata që kishin bërë ndonjë krim të rëndë, apo edhe thjesht që kishin qenë prezent në ndonjë vrasje të bërë nga dikush tjetër, si dhe kur dikush kërkonte ndonjë formë të veçantë mëshire siç ishte përjashtimi nga agjërimi për shkaqe shëndetësore, leje për të lëvizur nga një manastir apo urdhër monastik në një tjetër, apo për t'u larguar nga monastiri dhe për të rifilluar një jetë normale jashtë mureve të manastirit. Megjithatë, shkallualisht kompetenca e Penitencierisë së Shenjtë Apostolike u rrit aq sa të përballej me të gjitha grupet sociale dhe me të gjitha llojet e shkeljeve.

Duke qenë se detyra kryesore e Penitencierisë së Shenjtë Apostolike ishte formuluar si “dhënie e ilaçit dhe shërimit për mëkatet” dhe duke qenë se pothuajse çdo devijim ose gabim në mesjetë konsiderohej mëkat, nga mesi i shek. XVI, Penitenciera e Shenjtë Apostolike dispononte kompetenca juridike pothuajse universale. Zyra e Penitencierisë së Shenjtë Apostolike u bë një institucion real i Kurisë Papnore në mesjetën e vonë, dhe arkivat e saj janë ruajtur sistematikisht që prej mesit të shek. XV e në vazhdim, dhe konkretisht nga viti 1458, 1459, kur në krye të penitencierisë vjen kardinal Kalandrini, i cili e reformoi mënyrën e regjistrimit të rasteve.

Gjatë pontifikatit të Papa Piut II (1458-1464), organizimi i brendshëm i regjistrave ndryshoi duke filluar nga numri 7 e në vijim. Më përpara, rastet vetëm kopjoheshin në formë zërat në vëllime pa asnjë rregull, por duke filluar nga vëllimi 7 të gjitha kërkesat ndahen në disa kategori ku secila mban një titull të veçantë. Kjo ndarje respektohet edhe në regjistrat e mëvonshëm. Gjatë pontifikatit të Papa Piu II, kishte nëntë kategori: *De matrimonialibus* (martesat), *De diversis formis* (forma të ndryshme), *De declaratoriis* (deklaratat), *De defectu natalium* (defektet e lindjes), *De uberiori* (të tjera), *De promotis et promovendis* (promovimi dhe në pritje të promovimit), *De sententiis generalibus* (dënimet e përgjithshme), *De confessionalibus in forma 'Cupientes'* (rrëfimet në formën e 'lakmisë') dhe *de confessionalibus perpetuis* (rrëfimeve të përvetshme). Më vonë kategoritë *De diversis formis* (forma të ndryshme) dhe *De declaratoriis* (deklaratat) u bashkuan nën titullin *De diversis*

materies (çështje të ndryshme) dhe kategoritë *De defectu natalium* (defektet e lindjes) dhe *De uberiori* (të tjera) u bashkuan nën titullin *De illegitimiis* (ilegjimititeti).

Renditja e rregullt ishte e rëndësishme kryesisht për vetëm funksionarët e Penitencierisë Apostolike, sepse sa herë që paraqitej një rast i ri duheshin konsultuar rastet preçedente, si për të parë zgjidhjen që u bëhej rasteve të ngjashme ashtu edhe për të parë, nëse i njëjti person shfaqet për të parën apo të disatën herë. Po kështu ndodhte që dikush kishte humbur indulgjencën, p.sh. nga një zjarr, dhe dëshironte një kopje të re të saj. Në këtë rast duheshin konsultuar regjistrat e vjetra për të gjetur vendimin e mëparshëm.

Si rezultat i rritjes së autoritetit të zyrës majore të Penitencierisë së Shenjtë Apostolike, regjistrat përmbajnë një sasi të jashtëzakonshme materiali që mund të eksplorohej jo vetëm nga pikëpamja kishtare, por edhe nga pikëpamja e historisë sociale, ekonomike, e kulturore në përgjithësi. Penitencieria e Shenjtë ishte e hapur për suplika të çdo shtrese sociale, prandaj studiuesit i konsiderojnë këto regjistra si burimi më i pasur ekzistues për të zbuluar “histori të vërteta të shkruara nga vetë njerëzit në mesjetë e të drejtuara vetë papës”.⁴ Për këtë arsye ato mund të trajtohen edhe nga studiues të antropologjisë historike dhe historisë sociale, të së drejtës penale, në shumë aspekte si në prosopografi, strukturë familjare, norma dhe praktika e beqarisë klerikale, iligjitimiteti, trashëgimtarët dhe trashëgimia, karrierat në dispozicion për burrat apo gratë në mesjetë, historia e të drejtës kanonike, normat kanonike dhe praktika papnore të zbatimit të tyre, normat dhe praktikat e inkuizicionit, gjyqet e shtrigave dhe të heretikëve, historia institucionale e zyrave kuriale, rritja e rregullave legale si përgjigje e nevojave sociale etj.

Penitencieria e Shenjtë Apostolike e filloi regjistrimin e rregullt të peticioneve që hynin dhe të zgjidhjeve që u jepeshin atyre në vitin 1409. Sot nuk na kanë arritur të gjithë regjistrat, sepse një pjesë e madhe e tyre humbën gjatë luftërave të Napoleonit, kur ky i fundit i mori të gjitha dokumentet e arkivave të Vatikanit dhe i transportoi në Paris për të krijuar atje një arkiv botëror. Pas rënies së Napoleonit shumë nga këto dokumente nuk u arrit të ktheheshin më në Vatikan për shumë arsye, me gjithë përpjekjet e Kurisë papnore në atë kohë. Humbja është llogaritur se arrin deri në një të tretën e gjithë regjistrave të transportuar në Paris. Nga njëra anë Kuria papnore nuk ishte në gjendje të transportonte të gjitha vëllimet,

⁴ Shih Arnold Esch, *Wahre Geschichten aus dem Mittelalter: Kleine Schicksale selbst erzählt in Schreiben an den Papst*. Munich: C. H. Beck, 2010.

sepse transporti ishte shumë i kushtueshëm, dhe nga ana tjetër disa nga anijet që po transportonin vëllime, u mbytën. Nga ato që mbetën në Paris, shumë vëllime u shitën si letër tregtarëve, fabrikave të letrës ose përdorëshin si material për t'u djegur. Megjithatë, regjistrat e Penitencierisë Apostolike sot përfshijnë një periudhë kohore prej gjysmëshekullit të pesëmbëdhjetë deri në gjysmëshekullin e tetëmbëdhjetë, dhe i gjithë fondi përbëhet prej rreth 4 500 vëllime. Regjistrat e Penitencierisë Apostolike janë depozituar në *Archivio Apostolico Vaticano* në vitin 1983, dhe janë hapur vetëm pas viteve '90 të shekullit të kaluar për një numër të kufizuar studiuesish, ku autorja e këtij studimi ka privilegjin që të jetë njëra prej tyre.⁵

Në fakt, jo i gjithë fondi është i hapur edhe për këta studiues, por vetëm ajo pjesë që i përket mesjetës *stricto sensu*, d.m.th. deri në vitin 1569, dhe vetëm ato dokumente që vijnë nga jo-kurialët, d.m.th. nga zyra majore e Penitencierisë Apostolike. Megjithatë, duhet të shtojmë gjithashtu që kjo është periudha kur *Sacra Penitenciera Apostolica* ushtroi kompetencës më të madhe dhe pati popullaritetin më të madh.

Në regjistrat e Penitencierisë Apostolike, përveç suplikave shënohet edhe lloji i faljes dhe i mëshirës që mori secili petent. Emri i petentit, dioqeza e tij e origjinës dhe shpesh edhe emri i vendit ku jetonte janë të pranishme në çdo zë të regjistruar, pastaj vjen një përshkrim i shkurtër, sidomos te rastet stereotipe si pengesat e martesave, ose një përshkrim i detajuar, kur petenti kërkonte deklaratë pafajësie për krimin që mund të kishte ndodhur në prani të tij. Vendimi i penitencierisë zakonisht shkruhej në fund të zërit të regjistruar dhe shprehet me formula të tilla si *fiat ut petitur* (le të bëhet siç është kërkuar nga petenti), *fiat de speciali* (le të bëhet në mënyrë speciale), ku vihej edhe emri i personit që jepte vendimin si dhe datën e regjistrimit të rastit.

Arkivi i Penitencierisë Apostolike, që sot ruhet në Arkivin Sekret të Vanikanit, por nën përgjegjësinë e Penitencierisë Apostolike, ka qenë i mbyllur për një kohë të gjatë në mënyrë shumë strikte, sepse për një kohë të gjatë është menduar që ky material përmbante dokumente të ashtuquajtura *pro foro interno* që do të thotë rrëfime që duhet të mbeten

⁵ Disa nga botimet e bëra në lidhje me këtë fond për territoret shqiptare janë: Etleva Lala, "The Survival of the Catholic Church in Albania during the Period of Direct Contact with the Ottomans (1458-1484)," në Gerhard Jaritz, Torstein Jørgensen, Kirsi Salonen, eds. *...et usque ad ultimum terrae – The Apostolic Penitentiary in Local Contexts*, CEU Medievalia 10 (Budapest: CEU, Department of Medieval Studies, 2007): 115-122. Po ajo, "Violence and the Clergy in Late Medieval Albania: With and Without the Penitentiary" Në *Violence and the Medieval Clergy*, ed. Gerhard Jaritz, Ana Marinkovic (Budapest: Central European University Press, 2011): 47-54.

përjetë të fshehta. Pasi ky arkiv u hulumtua nga vetë studiuesit e Vatikanit duke filluar nga vitet 1983, dhe u vërtetua që shumë prej këtyre dokumenteve nuk e mbajnë vulën e rrëfimeve, pra mund të bëhen publike, arkivi u hap edhe për një numër të kufizuar studiuesish nga jashtë Vatikanit.

Institucione me famë botërore filluan menjëherë punën në këto fonde. *Deutsche Historische Institut* në Romë, një ndër institucionet më të vjetra shkencore në botë, mjaft i njohur për standardin dhe rezultatet e punës së tij shkencore, sidomos nëpërmjet *Repertorium Germanicum*, filloi menjëherë punën hulumtuese shkencore për t'i përfshirë edhe këto dokumente në këtë seri me emrin *Repertorium Poenitentiarie Germanicum*. Puna kërkimore-shkencore si dhe botimi i rezultateve u bë me një intensitet të tillë që brenda këtyre viteve 1991-2010 janë botuar vëllimet respektive për tetë papë nga grupi i studiuesve gjermanë me në krye studiuesin e mirënjohur tashmë për këtë punë të jashtëzakonshme, Ludwig Schmutge.⁶

Vështrim diplomatik i letrave të Penitencierisë Apostolike

Sipas stilit kurial *stilus curiae*, letrat e hirit ose të faljes përbëheshin nga tre pjesë: *protocol*, *corpus* dhe *eschatocol*. *Protocol*-i në letrat e Penitencierisë përbëhet nga tre pjesë: *intitulatio*, *inscriptio* dhe *salutatio*. *Intitulatio* përfshin emrin dhe titullin e Penitenciarit kardinal, që ishte autori zyrtar i letrës së faljes. *Inscriptio* përfshin emrin dhe titullin e adresantit, në rastin tonë të petentit si p.sh. *Venerabili in Christo patri ... Dei gratia episcopo Drivastensi vel eius vicario in spiritualibus* (= *inscriptio*) *Dominicus miseratione divina tituli sancte Crucis in Ierusalem presbyter cardinalis* (= *intitulatio*). Radha e *inscriptio* dhe *intitulatio* mund të jetë edhe e përmbysur. Pastaj menjëherë vijon *salutatio*: *salutem et sinceram in Domino caritatem* or *Salutem in Domino*.

⁶ Ludwig Schmutge, Patrick Hersperger and Béatrice Wiggenhauser [Ediotr], *Repertorium Poenitentiarie Germanicum. Verzeichnis der in den Supplikenregistern der Pönitentiarie vorkommenden Personen, Kirchen und Orte des Deutschen Reiches, IV: Pius' II. 1458-1464*. Edituar nga Ludwig Schmutge, Patrick Hersperger and Béatrice Wiggenhauser; indices by Hildegard Schneider-Schmutge dhe Ludwig Schmutge (Deutsche Historische Institut in Rom.) ff. xxxvi+534. Tübingen: Niemeyer, 1996. [ff. xxxvi+534] DM 158. 3 484 80145 X; Ludwig Schmutge, Patrick Hersperger dhe Béatrice Wiggenhauser, *Die Supplikenregister der päpstlichen Pönitentiarie aus der Zeit Pius' II. (1458-1464)*. Nga Ludwig Schmutge, Patrick Hersperger dhe Béatrice Wiggenhauser. (Bibliothek des Deutschen Historischen Instituts in Rom, 84.) pp. xii+273 (Tübingen: Niemeyer, 1996) [ff. xii+273]

Thelbi ose trupi i letrës, *corpus*, i cili përbëhet nga shumë pjesë të ndryshme vjen menjëherë pas përshëndetjes: *arenga, narratio, dispositio, clausulae* dhe parapergatitja retorike e çështjes. Në dokumentet e penitencierisë shumë lloje *arengae* mund të dallohen varësisht nga çështja e ngritur. *Arenga* ndysoi me kalimin e kohës dhe ndonjëherë edhe mungon plotësisht.

Narratio varion sipas prezencës fizike ose mungesës së petentit në kuri dhe përmban detaje të rastit, duke treguar arsyet se përse petenti po bën një suplikë në Penitencieri. Kur ai nuk është prezent në Kuri, *narratio* është në formën pasive: *Ex parte N.N. nobis oblata petitio continebat ...*. Nëse petenti ishte i pranishëm, fraza ishte në formë aktive: *Sua nobis N. N. Lator presentium petitione monstravit* Pas kësaj fraze, detajet e çështjes dhe vetë suplika jepen me besnikëri duke përsëritur të gjitha fjalët e suplikës. Kur petenti nuk është prezent në kuri, *narratio* përfundon kështu: *... (super quibus) supplicari fecit humiliter dictus exponens sibi super hiis per sedem apostolicam misericorditer provideri*, dhe në rastin kur ai është i pranishëm, përfundon kështu: *... super quibus supplicavit humiliter dictus exponens sibi super hiis per sedem apostolicam misericorditer provideri*.⁷

In *dispositio*, gjendet vendimi përfundimtar i Penitencierisë Apostolike. Kur një petition miratohet sipas autoriteteve të përgjithshme të Penitencierisë (*in forma*), formula e *dispositio* fillon: *nos igitur ... auctoritate domini pape, cuius penitentiariae curam gerimus* Nëse vendimi i Penitencierisë bëhet me dispozita të veçanta të zyrës (*de speciali*) fraza vazhdon: *... et de eius speciali mandato super hoc vive vocis oraculo nobis facto...*. Në rastet kur Penitencieria e ka marrë vendimin e saj në harmoni me mandatin ekspres nga papa, fraza: *de speciali et expreso* mund të gjendet e shoqëruar me: *... et de eius commissione in talibus generaliter nobis facta ...* që nuk u përket kompetencave të zakonshme të kësaj zyre. Nëse shqyrtimi i rastit i është referuar autoriteteve vendore apo kuriale, ky fakt përmendet menjëherë pas vendimit: *... circumspeditioni vestre committimus Dispositio* mbyllet me vendimin e Penitencierisë që është deklarata, dispensa, absolutioni, apo dhënia e një leje të veçantë.

⁷ Filippo Tamburini, "Note diplomatiche intorna a suppliche e lettere di Penitenzieria (sec. XIV-XV)," Në *Archivum Historiae Pontificiae* vol. 11 (1973): 149-208. f. 181; shih gjithashtu veprat e tjera të Tamburinit, "Il primo registro di suppliche del'archivio della Sacra Penitenzieria Apostolica," Në *Rivista di storia della chiesa in Italia* vol. 23 (1969): 384-427; idem, "Note diplomatiche alle 'litterae' del cardinal penitenziere (secoli XIV-XV), Në *Annali della Scuola Speciale per Archivisti* vol. 11 (1971): 122-131.

Dispositio ndiqet nga një klauzulë që përcakton vlefshmërinë e letrës së mëshirës dhe deklaron që Penitencieria e ka plotësuar kërkesën e petentit në lidhje me të gjitha çështjet e përmendura në letër. Në këtë pjesë, frazeologjia varion sipas llojeve të ndryshme të çështjeve. Këto fraza, zakonisht ndiqen nga përmendja e vulës së Penitencierisë: *In huius rei testimonium presentes litteras sigilli nostro munitas duximus concedendas.*

Escatocoli i letrave të Penitencierisë përbëhet nga *datatio*. Siç mund të paramendohet, data shkruhet sipas rregullave të përgjithshme të respektuara nga Kuria papnore: vendi i lëshimit, pastaj konfirmimi që Penitencieria e ka dhënë miratimin, dhe në fund, dita, muaji, dhe viti i pontifikatit të papës në fuqi.

Letrat e dala nga Penitencieria përmbajnë edhe informacione shtesë që i referohen fazave të ndryshme në procesin e përgatitjes së tyre. Në margjinën e sipërme, mbi tekst, një frazë shkruhet nga korrektori: *videat eam N.N. / dominus regens / dominus auditor*, varësisht se kush e merr vendimin.

Nëse vendimmarrësi, pasi e shqyrton letrën, e konsideron atë të shkruar në mënyrë korrekte, ai shkruan në margjinën e majtë në nivelin e radhës së pestë: *Visa per me*. Ai shton emrin dhe titullin e tij në margjinën e djathtë në të njëjtin nivel. Nëse personi që e kontrollon letrën për korrektësi ishte një ipeshkv, apo abat, ai shkruan shkronjat e para të emrit të tij ndjekur nga titulli i tij kishtar, p.sh. *Jo(hannem) ep(iscopu)m Nucerin(ensem)*. Nëse vendimmarrësi ishte një zyrtar tjetër i Penitencierisë, ai shkruan emrin dhe mbiemrin si dhe titullin e tij: *A(nthonium) de Grassis, auditorem*. Në rastet e thjeshta, si në letrat e rrëfimit, nuk kishte nevojë për të kontrolluar përmbajtjen e letrës dhe korrektori shkruante *Bene* në margjinën e majtë.

Në fund të letrës, në qoshen e majë, nën palosje, mund të lexohen dy ose tre emra. Në rreshtin e sipërm, emri i *distributor*-it (i cili vepronte gjithashtu edhe si *taxator*) përfshihet në shumën e taksës që duhet të paguajë petenti në Penitencieri. Shuma shkruhet në mes të emrit të *distributor-taxator*-it, për të Poshtëmuar mundësinë e mashtrimit p.sh. *F. Rosextursa* (d.m.th. F. Rosa, 6 *turonenses*). Emri i dytë është ai i *computator*-it që merrte pjesë në vendosjen e taksës. Emri i tretë që nuk është i pranishëm në të gjitha letrat, mund të jetë ai i prokuratorit, megjithëse kjo nuk është e sigurt, përderisa emri i tij del zakonisht në pjesën e pasme, *verso*, të dokumentit.

Për më tepër, në cepin e djathtë në fund, gjejmë edhe emrin dhe mbiemrin e skribit që e shkroi letrën. Nëse letra ishte e mbyllur *litterae clausae*, prokuratori firmos me emrin e tij në palosje, por në krahun e majtë. Nëse letra ishte një letër normale papnore, prokuratori firmos me emrin e tij në pjesën e prapme *verso* të letrës. Në pjesën e prapme të dokumentit, është edhe emri i një personi të cilit i duhet dhënë letra, megjithëse emri i tij ndoshta nuk është shkruar nga zyrtarët e Penitencierisë Apostolike, por nga prokuratori.

Penitencieria Apostolike nuk i regjistronte letrat që dilnin deri në vitin 1570. Letrat e hirit apo të faljes që dërgoheshin nga zyra, nuk regjistroheshin asgjëkund në zyrë. Për këtë arsye, letrat e Penitencierisë mund të gjenden vetëm në arkivat vendore, dhe numri i tyre është relativisht i poshtëm, për arsyet që i përmendëm edhe më sipër.

Si i merrte vendimet Penitencieria?

Megjithëse arsyet se pse petentët i drejtoheshin Penitencierisë, mund të ekzaminohen relativisht lehtë, çështje të tjera të lidhura me procesin e suplikimit mbeten akoma pa përgjigje. Si e dinin petentët se te cila zyrë duhet të drejtoheshin kur shkonin e Kuria Papnore, dhe çfarë duhet të bënin për të fituar një letër faljeje janë pyetje, përgjigja e të cilave nuk është e lehtë. Të dije si të silllesh në labirintin e Kurisë Papnore dhe të ishe në gjendje të shprehesh me fjalët e duhura dhe me shpjegimet e duhura nuk ishte punë e lehtë për askënd. Procesi i suplikimit pra ishte i gjatë dhe i ndërlikuar.

Procesi i suplikimit fillonte në shtëpi, kur merrej vesh që petenti kishte bërë diçka të gabuar dhe që për t'u pastruar i duhej një leje apo dispensë. Kjo vlen edhe për rastet kur personi donte që të bëjë diçka që ishte e ndaluar nga E Drejta Kanonike. Kur dikush kuptonte që ai apo ajo kishte vepruar në kundërshtim me rregullat e Kishës Katolike, gjëja e parë ishte të rrëfehej. Në rastet normale, ati konfesor e dëgjonte rrëfimin, e falte mëkatarin e penduar dhe kaq. Kur shkelja ishte veçanërisht e rëndë, prifti famullitar nuk kishte të drejtë ta shpengonte mëkatarin, por duhet ta dërgonte atë te autoriteti sipër tij, që mund të ishte ipeshkvi, kryeipeshkvi ose edhe legati papnor që kishte kompetenca më të mëdha. Në shumë raste, ipeshkvi vendor mund ta falte mëkatarin për një sërë mëkatesh, por kishte mëkate të cilat nuk ishin në kompetencën e tij. Kishte mëkate, falja e të cilave i ishte rezervuar vetëm autoritetin papnor dhe ipeshkvi apo

kryepeshkvi nuk kishte rrugë tjetër, veçse ta udhëzonte mëkatarin të shkonte te kuria papnore.

Ekzistonin dy mënyra për suplikantët që t'i çonin rastet e tyre te kuria papnore: mënyra e parë ishte të niseshin personalisht për në Romë, edhe pse kjo mundësi nuk përdorej shpesh, por kryesisht në rastet kur petenti ishte klerik dhe kishte nevojë që rasti i tij të shpengohej sa më parë që të ishte e mundur për t'u kthyer përsëri në postin e tij dhe për të marrë të ardhurat e tij. Mënyra e dytë ishte të përdornin korrierët e ipeshkvit vendor, të cilët pasi i sillnin rastet në Romë, i kalonin ato te përfaqësuesit e ipeshkvit vendor në Kuri. Për shqiptarët nuk ishte gjithmonë i mundur ky variant, sepse ipeshkvit shqiptar nuk kishin përfaqësues të përhershëm në Kuri. Mënyra e tretë ishte të çohet kërkesa në Kurinë papnore duke përdorur si korrier një shok apo të afërm që shkonte për pelegrinazh në Romë.

Ndonjëherë, ipeshkvi vendor ishte promotori i peticioneve të drejtuara për në Kurinë Papnore. Në raste të tjera petenti i drejtohej Penitencierisë Apostolike pa u konsultuar me ipeshkvin vendor. Kjo ndodhte sidomos kur petenti ishte në nxitim e sipër për të vënë në vend ndërgjegjen e tij, ose kur ai kishte frikë nga reagimi i ipeshkvit dhe donte të fitonte një dokument papnor për t'u mbrojtur.

Kur çështja arrinte te Kuria Papnore, zakonisht i besohej një prokuratori të veçantë të Penitencierisë. Prokuratorët ishin njerëz të specializuar për shkrimin dhe prezantimin e kërkesave dhe paguheshin për shërbimin e tyre. Prokuratorët dinin si të procedonin me një proces peticioni, dhe si të shkruanin suplikatat sipas rregullave të Kurisë papnore, kështu që luanin një rol të rëndësishëm, duke ditur që fjalët e duhura në suplikë bënin që petenti të fitonte atë që donte.

Kur suplika shkruhej, prokuratori e dërgonte atë te Penitencieria Apostolike dhe pastaj fillonte shqyrtimi i rastit. Kërkesa fillimisht merrej nga zyrtarët që quheshin auditorë, juristë të specializuar detyra e të cilëve ishte të shqyrtonin suplikën nga pikëpamja formale: nëse ishte shkruar në mënyrën e duhur dhe nëse çështja bënte pjesë në kompetencat e Penitencierisë Apostolike. Nëse kërkesa ishte formalisht korrekte, ata e përgatisnin rastin dhe e paraqisnin suplikën te kardinali penitenciar ose te regenti, i cili e miratonte kërkesën me firmën e tij. Para se ta merrte kërkesën për aprovim, auditori shkruante një përmbledhje të shkurtër në qoshen e majtë sipër, gjë që lehtësonte dhe shpejtonte vendimmarrjen, sepse vendimmarrësit vetëm lexonin përmbledhjen dhe jo të gjithë tekstin e kërkesës. Pasi kërkesa pranohej dhe firmosej, origjinali kthehej te

prokuratori, që e dorëzonte te *distributor*-i, i cili nga ana e tij e çonte atë te *corrector*-i i zyrës. Përgjegjësia e korrektorit ishte të shkruante një shënim të quajtur *minutë*, për letrën e hirit në bazë të gjitha detajeve të domosdoshme të përmendura në kërkesë. Kur *minuta* ishte gati, distributori e shpinte atë te një nga skribët e zyrës që hartonte letrën e mëshirës. Kur letra ishte gati, merrej nga *datarius* për të vendosur datën, dhe kthehej pas te distributori që bashkë me komputatorin shkruante shënimin e taksës së zyrës dhe emrin e tyre në pjesët e poshtme në qoshen e majtë të letrës.

Pas të gjitha këtyre hapave, letra e faljes kthehej te personi që e kishte miratuar kërkesën p.sh. kardinali penitenciar apo regenti, dhe në disa raste deklarative edhe te auditori. Ky vendimmarrës, kontrollonte që përmbajtja e letrës korrespondonte me vendimin dhe që letra ishte hartuar në mënyrë korrekte. Nëse letra ishte e pranueshme, korrektori shkruante një shënim në margjinën e letrës: *Videat eam N.N. / dominus regens / dominus auditor* dhe vendimmarrësi shkruante në margjinën e majtë në nivelin e rreshtit të pestë të letrës një shënim që konfirmonte që ai e kishte kontrolluar atë: *visa per me* dhe në të njëjtin nivel në margjinën e djathtë shkruante emrin dhe titullin e tij. Kjo praktikë garantonte që letra ishte kontrolluar dhe ishte gjetur e saktë. Kontrollimi i kërkesës ishte i rëndësishëm, sepse garantonte që askush nuk duhet të përfitonte apo të vuante në rast se Penitencieria Apostolike kishte bërë një gabim në hartimin e letrës së faljes dhe të nëpërkëmbte autoritetin e kësaj zyre. Kontrolli i letrës nuk ishte gjithmonë i nevojshëm të bëhej në këtë mënyrë të komplikuar, sepse në shumicën e rasteve rutinë ishte e mjaftueshme që korrektori ta kontrollonte letrën dhe të shkruante *Bene* në margjinën e majtë si shenjë e kontrollit. Në raste të tilla, letra nuk dërgohej fare te vendimmarrësit.⁸

Në këtë fazë të procesit të kërimit, prokuratori merrte edhe kërkesën origjinale edhe letrën e mëshirës që jepen në emër të kardinalit penitenciar. Prokuratori e çonte pastaj letrën te *sigillator*-i që vendoste vulën e Penitencierisë, duke garantuar me anë të saj autenticitetin e letrës. Detyra e fundit e prokuratorit ishte të sigurohej që një nga skribët e kishte regjistruar kërkesën në regjistrat e Penitencierisë. Nëse edhe regjistrimi kishte përfunduar dhe prokuratori kishte paguar taksat e zyrës, procesi i

⁸ Për procedurat e penitencierisë, shih Ludwig Schmugge, Patrick Hersperger dhe Béatrice Wiggenhauser, *Die Supplikenregister der päpstlichen Pönitentiarie aus der Zeit Pius' II (1458-1464). The Administration of Conscience. The supplication registers of the Penitentiary under Pope Pius II (1458-1464)* vol. 84 Bibliothek des Deutschen Historischen Instituts in Rom (De Gruyter, 1996): 41- 48.

suplikimit kishte përfunduar dhe prokuratori mund të largohej nga zyra me letrën e mëshirës për ta dorëzuar atë apo për ta dërguar te petenti apo përfaqësuesi i tij.

Si të gjitha zyrat papnore, edhe Penitencieria Apostolike kishte pushtetin që t'i dhuronte petentit një favor të veçantë: kërkesa origjinale mund të funksiononte si dëshmi e hirit së dhënë dhe në këtë rast nuk kishte nevojë për letër tjetër faljeje. Në këto raste, kërkesa e miratuar dhe e firmosur ishte dëshmi e mjaftueshme që falja ishte dhënë dhe petenti duhet vetëm të mbante kërkesën origjinale, pasi të kopjohej në regjistrat e Penitencierisë Apostolike. Duke qenë se vlefshmëria e kërkesës origjinale justifikohet vetëm nëpërmjet firmës zyrtare, ky lloj dokumenti quhej kërkesë me *sola signatura*.⁹ Marrja e një dispense apo shpengimi në formën e *sola signatura* ishte me shumë përfitim për petentin, sepse ai nuk duhet të paguante taksat për përgatitjen e letrës së faljes.

Megjithatë, procesi nuk mbaronte kur letra e faljes ishte gati. Një ndër fazat më të rëndësishme ishte ta sillje atë (ose kërkesën *sola signatura*) në shtëpi dhe ta paraqisje atë te ipeshkvi vendor, ose te personi që ishte përgjegjës për vendimin përfundimtar si provë që rasti ishte trajtuar dhe zgjidhur nga Kuria Papnore. Dokumenti i lëshuar nga Penitencieria Apostolike provonte që petenti e kishte marrë mëshirën e kërkuar. Para se çështja të zgjidhej plotësisht, i dërguari duhet të verifikonte që detajet e përmendura në letrën e faljes ishin të sakta dhe vetëm pas kësaj ai mund ta deklaronte letrën e faljes si të vlefshme. Nëse detajet ishin të rreme, falja anulohet.

Rastet që paraqiteshin në Penitencierinë e Shenjtë Apostolike

Në përmbajtjen e rasteve drejtuar Penitencierisë Apostolike ndeshemi me shumë tregime personale të mijëra rasteve që variojnë nga krime të vërteta që janë krime edhe me termat e sotme juridike si vrasje apo plagosje, ashtu edhe me shkelje të së Drejtës Kanonike, të cilat për lexuesin e zakonshëm modern nuk përbëjnë krime në kuptimin e mirëfilltë të fjalës, si braktisja apo ndërrimi i manastirit, marrja e një posti kishtar pa qenë i denjë për të, prishja e celibatit, thyerja e premtimit apo fjalës së dhënë, thyerja e kurorës apo martesë të ndaluara, etj. Në vijim do të japim

⁹ Në lidhje me këtë lloj suplike shih Thomas Frenz, *Papsturkunden des Mittelalters und der Neuzeit*, 2. aktualisierte Aufl., Stuttgart 2000, 34. (§ 31); Bruno Katterbach OFM (coll.), *Specimina supplicationum ex registris Vaticanis, pars I: Prolegomena et tabulae, pars II: Transcriptiones et annotationes*, Roma 1927.

gamën e gjerë të këtyre rasteve në mënyrë të organizuar dhe të kategorizuar për të treguar harkun e gjerë të fushave të jetës që përfshijnë të gjitha këto tregime personale të ardhura nga i gjithë krishterimi perëndimor evropian.

Ajo që duhet të mbajmë parasysh kur interpretojmë këto lloj burimesh është se edhe pse janë copëza jete të jetuara vërtet, dhe të shkruara nga vetë të interesuarit dhe jo shpikje të ndonjë autori, ato kanë kaluar nëpër një filtër, të cilin duhet ta mbajmë parasysh, kur i analizojmë dokumentet. Ajo që na bie në sy që në fillim me këto raste është centralizimi me të cilën Kisha Katolike trajtonte çështjet e jetës së asaj kohe, duke përfshirë këtu edhe atë private. Besimtarët, si klerikët ashtu edhe laikët, e kanë të organizuar jetën dhe të menduarit e tyre në mënyrë të tillë që edhe kur nuk kontrollohen nga jashtë të kontrollojnë vetveten me vrarjen e ndërgjegjes dhe shkeljet që kanë bërë apo që mendojnë se kanë bërë në mënyrë që t'i nxjerrin në dritë duke i shkruar ato. Në këtë këndvështrim Penitenciera Apostolike ishte edhe një gjyq i ndërgjegjes dhe ekuilibruet i jetës socio-psikologjike të gjithë shoqërisë së krishterë në Perëndim.

Në gjithë këtë proces, megjithatë, duhet të mbajmë parasysh faktin se duke u shkruar nga vetë të interesuarit, letrat përmbajnë edhe shumë subjektivizëm, që duhet shqyrtuar dhe analizuar në kontekst. Në rastet më të thjeshta petentët/të interesuarit nuk kanë mbajtur mend të gjitha detajet e ngjarjeve, por në raste më të ndërlikuara, ata me qëllim i kanë shtrembëruar detajet për ta paraqitur veten në një dritë më të mirë. Kështu shumë nga petentët e përshkruanin rastin në mënyrë të tillë që faji të ishte sa më i pranueshëm duke rënë mbi të tjerët apo mbi rrethanat.

Rastet e *De matrimonialibus* pasqyrojnë nevojën për të pasur një *dispensatio* (leje) në rastet kur çifti nuk ishte martuar akoma, ose një *absolutio* (falje) kur çifti ishte i martuar tashmë dhe dëshironte të qëndronte i martuar.¹⁰ Bëhet fjalë për ato martesë ku bashkëshortët ishin në afërsi gjaku. Kategoria e *De diversis formis* është pak e ndryshme nga kategoritë e tjera, sepse përfshin tipe të ndryshme kërkesash dhe nuk i referohet vetëm një lloji hiri.

Grupi i *De declaratoriis*¹¹ përfshin kërkesën për të marrë një letër deklaruese që e liron dikë nga akuzat e vrasjes, martesës së paligjshme,

¹⁰ Shih gjithashtu Filippo Tamburini, "Le dispense matrimoniali come fonte storica nei documenti della Penitenzieria apostolica," Në *Le modèl familial européen* (1986): 9-30.

¹¹ Për kategorinë "de Declaratoriis" shih Kirsi Salonen and Ludwig Schmutge, *A Sip from the Well of Grace*, 49-56.

ose të karrierës së detyruar monastike. Grupi i *De defectu natalium*¹² përfshin kërkesa të klerikëve për të pasur një indulgjencë të thjeshtë (*dispensatio*) nga legjitimiteti dhe të drejtën për të mbajtur një benefit kishtar, pavarësisht nga ilegjitimiteti i suplikuesit. Kategoria *De uberiori* përfshin kërkesa nga fëmijë ilegjitim për t'u pajisur me një leje që i lejon ata të shugurohen priftërinj si dhe të mbajnë edhe benefice shtesë.

Kategoria *De promotis et promovendis* përfshin leje dhe falje që lidhen me çështjet e ngritjeve në detyrë dhe të shugurimeve. Grupi *De sententiis generalibus* përfshin kërkesa nga priftërinjtë që të autorizohen për të falur anëtarët e famullive të tyre nga mëkatet që normalisht janë të rezervuara vetëm për vendimet e papës. Grupi (*De confessionalibus perpetuis* përfshin kërkesa për të marrë një letër rrëfimi që e lejon mbajtësin ta zgjedhë vetë priftin ku dëshiron të rrëfëhet. Në kategorinë *De confessionalibus in forma 'Cupientes'* janë ruajtur kërkesat për t'u çliruar nga mëkate lakmie të rënda të cilat nuk mund t'i falë prifti.

Dhuna, vrasja, pjesëmarrja në luftë apo në gjykime

Penitencieria Apostolike ka kryesisht dokumente që kanë të bëjnë me krime, dhunë, vrasje, shkelje ligji e gjëra të ngjashme. Të gjithë të krishterët që ishin në një mënyrë apo tjetër të lidhur me vdekjen e një personi ishin automatikisht fajtorë dhe *ipso facto* të shkishëruar. Po kështu edhe priftërinjtë që konsideroheshin fajtorë për vrasje: ata nuk lejoheshin të vazhdonin karrierën e tyre kishtarë, pa vërtetuar pafajësinë e tyre. Pafajësia sigurohej duke marrë një deklaratë papnore që vërtetonte se i akuzuari nuk ishte fajtor për krimin për të cilin akuzohej, ose që ishte i falur për krimin që kishte bërë. Logjika ishte që nëse mëkati/krimi është falur nga Zoti, kush mund të dalë mbi Zotin dhe të mos e falë atë? Zakonisht praktika ishte që në momentin që një deklaratë e tillë papnore prezantohej në komunitet, jo vetëm që të gjithë ishin të detyruar ta konsideronin personin të falur e të larë nga ai mëkat, por bashkëngjitur vlente edhe detyrimi i heshtjes: askush nuk kishte të drejtë më që ta kujtonte mëkatin/krimin që kishte ndodhur, sepse ai ishte falur në qiell, e rrjedhimisht si i tillë, pra i falur, duhej konsideruar edhe në tokë. Për të marrë një deklaratë të tillë papnore, ishte e rëndësishme që kërkuesi/petenti, ose të tregonte pendesë të thellë e të pranonte krimin e

¹² Shih gjithashtu Filippo Tamburini, "Die Apostolische Pönitentiarie und die Dispense, super defectu natalium." In *Illegitimität im Spätmittelalter*, Schriften des Historischen Kollegs, Kolloquien/29 (Mynich, 1994): 123-132.

bërë me gjithë brutalitetin e tij, ose të mund të demonstronte pafajësinë e tij me terma ligjore. Për këtë, sigurisht që duheshin përdorur të gjitha strategjitë juridike që justifikonin pendesën apo pafajësinë, gjë që sigurisht kërkonte njohje të mirë të së Drejtës Kanonike, në mënyrë që të përfitonte nga ekzistenca e disa rrethanave të jashtëzakonshme që ishin jashtë pushtetit të njeriut në të Drejtën Kanonike. Pendesa ishte zakonisht më e lehtë që të falej, prandaj shumica e rasteve në Penitencierinë e Shenjtë janë të tilla. Që pafajësia të mund të provohej ishte më e komplikuar, sepse duheshin prova për këtë dhe dëshmitarë, gjë që kërkonte në radhë të parë që ngjarja të përshkruhej me shumë detaje, dhe që prokuratori ta prezantonte atë siç duhej me shkrim.

Meqenëse E Drejta Kanonike lejonte përdorimin e dhunës për vetëmbrojtje, shumica e suplikantëve që kërkonin pafajësi apo edhe pendesë e përdornin shumë shpesh këtë argument. Për të justifikuar përdorimin e dhunës për vetëmbrojtje, petenti përshkruante në *narratio* sesi armiku i tij e kishte sulmuar i pari, dhe si ai kishte qenë i detyruar të mbrohej nga vdekja e sigurt. Megjithatë, E Drejta Kanonike, paracaktonte që vetëmbrojtja nuk duhet të teprohej, dhe duhej përdorur vetëm minimumi i dhunës së lejuar, prandaj petentët që përdornin justifikimin e vetëmbrojtjes duhet të ishin në gjendje të demonstronin se nuk e kishin ekzagjeruar përdorimin e dhunës, kur ishin mbrojtur. Për këtë arsye, shumë shpesh në tekste të tilla gjejmë argumentin që suplikantët e kishin goditur armikun e tyre vetëm një herë të vetme, por ai kishte vdekur.

Për sa i përket klerikëve, çështja ishte akoma më e komplikuar: E Drejta Kanonike nuk i lejonte klerikët që të mbanin armë, prandaj kleriku fajtor për vrasje duhet të ishte në gjendje të demonstronte që ai nuk kishte pasur armë të vetën, por rastësore, ato që i ishin ndodhur në dorë apo përqaqark në atë kohë, si p.sh. një thikë të poshtme buke që e përdorte për përdorim të përditshëm, ose ndonjë instrument që gjendej rastësisht aty në vendin e krimit, si gur, sopatë, etj. Për shkak të këtij kufizimi, kleriku petent duhet të përmendte gjithmonë se çfarë arme kishte përdorur për krimin. Në përgjithësi, tre principet e përmendura më sipër, që janë vetëmbrojtja, minimaliteti i dhunës së përdorur, dhe instrumenti i rastësishëm, çuan në një frazë tipike të formulave që përdoren për këto raste në shkrimin e suplikave, variante të së cilës gjenden pothuajse në të gjitha rastet e krimeve: *vim vi repellendo et se defendendo unico ictu cum parvo cultello percussit* (duke iu përgjigjur dhunës me dhunë dhe duke mbrojtur veten, ai e goditi atë vetëm një herë me një thikë të poshtme). Sigurisht që kjo frazë paraprihej nga shpjegimi se pse petenti u gjend në

një situatë të tillë, ku nuk kishte zgjedhje tjetër por të fillonte të luftonte armikun. Rasti tjetër i marrjes së një letre deklarative për të provuar pafajësinë e dikujt ishte që petenti ta tregonte historinë në mënyrë të tillë që të dukej që nuk kishte qëllim që ta vriste viktimën, por që vdekja ndodhi aksidentalisht.

Penitencieria Apostolike jepte letra deklarative edhe për njerëz të cilët akuzoheshin për vrasje, por që nuk kishin fare të bënin me krimin në fjalë. Sipas të Drejtës Kanonike, nëse dikush gjendej rastësisht në vendin ku bëhej vrasja dhe automatikisht ishte bërë dëshmitar i vrasjes, edhe pse nuk kishte marrë pjesë në asnjë mënyrë në ngjarjet që kishin çuar në vrasjen e viktimës, konsiderohej fajtor për vrasjen, dhe rrjedhimisht shkishërohej automatikisht. Në këto raste, Penitencieria Apostolike i kërkonte petentit që të vërtetonte se nuk e kishte ndihmuar, këshilluar apo favorizuar vrasësin në ndonjë mënyrë dhe formula që përdorej në këto raste ishte si në vijim: *...vocatīs vocandīs ... quod exponens in morte dicti defuncti non consenserit auxilio, consilio vel favore...* (... duke thirrur ... se eksponenti në vdekjen e të ndjerit në fjalë nuk pranoi të ndihmojë, këshillojë ose favorizojë...)

Sigurisht që lufta paraqet një situatë, ku edhe në mos kesh vrarë njeri, gjë që është pothuajse kundër logjikës së luftës, është fakt i sigurt që ke qenë prezent në vrasjen e njerëzve apo në vdekjen e tyre. Pra automatikisht, të gjitha ata që merrnin pjesë në luftë, madje edhe ata që merrnin pjesë në një seancë gjyqësore ku fajtori dënohej për ndonjë vrasje, konsideroheshin pjesëmarrës në vrasje dhe duhet të parashtronin një suplikë te Penitencieria Apostolike për të pasur mundësi të marrin pjesë rregullisht në jetën e përditshme sociale, sidomos kur ishte fjala për të kryer funksione kishtarë. Ata që arrinin të provonin që nuk kishin marrë pjesë vullnetarisht në luftë, merrnin një letër deklarative që dëshmonte që nuk ishin fajtorë për ndonjë vdekje, sepse nuk kishin vrarë me qëllim.

Marrja pjesë në luftë në mënyrë të pavullnetshme ndodhte shpesh kur mbreti, apo sundimtari i detyronte burrat të shkonin në luftë. Po kështu, marrja pjesë në një proces gjyqësor që kishte shkaktuar vdekjen e dikujt, ishte rast i zakonshëm, sidomos kur ishte thirrur si dëshmitar pa vullnetin personal, dhe prandaj edhe në këto raste mund të merrej lehtësisht një letër deklarative që dëshmonte pafajësinë e petentit, sidomos nëse mund të demonstroi që ishin detyruar të ishin të pranishëm në gjyq për shkaqe të jashtme, p.sh. si sekretar apo skrib, vetëm sepse dinte shkrim e këndim.

Dhuna dhe vrasjet janë çështje që hasen shpesh në dokumentet e Penitencierisë, sidomos në rubrikat *de diversis formis* dhe në *de declaratoriis*. Në kategorinë e *de declaratoriis*, kërkuesit i drejtoheshin Penitencierisë për një letër deklaruese që dëshmonte që ata nuk ishin fajtorë për vrasje, edhe nëse kishin qenë pjesëmarrës në ngjarjen që shkaktoi vdekjen e dikujt. Petentët, shpesh priftërinj, kishin nevojë për deklarata të tilla, sepse pa to nuk mund të vazhdonin karrierën e tyre kishtarë, duke qenë se E Drejta Kanonike nuk i lejonte të akuzuarit për vrasje të ushtronin detyrën e priftit, dhe sidomos të rrëfyesit. Nga ana tjetër, në kategorinë e *de diversis formis*, suplikantët, shpesh laikë, zakonisht pranonin që ishin fajtorë për vrasjen dhe kërkonin falje për krimin e bërë, duke i shpëtuar kështu dënimeve që parashikonte E Drejta Civile dhe Penale.

Mosha dhe statet e jetës në rastet individuale

Fëmijëria. Në regjistrat e Penitencierisë ka shumë rrëfime që kanë të bëjnë me moshën e hershme të fëmijërisë. Kështu p.sh. shpesh kemi raste të fëmijëve që kanë pësuar gjymtime fizike gjatë kohës kur kanë qenë fëmijë. Po kështu, në rastet e penitencierisë ka edhe shumë kujtime kur një fëmijë është ndier fajtor për vdekjen e një foshnje në djep, apo aksidentalisht nga të rrëzuarit bashkë me fëmijën në pragun e lagur të shtëpisë. Kështu një fëmijë tetë-vjeçar “duhej që sipas porosisë së nënës ta merrte foshnjën (*infantulum*) në krahë dhe ta çonte në shtëpi, por sapo hyri në shtëpi rrëshqiti te pragu i lagur nga shiu (*propter pluvia madefactus*) dhe u përplas përtokë bashkë me foshnjën, që e përplasi kokën kaq fort sa ajo vdiq pas tetë ditësh”. Po kështu edhe të rriturit tregojnë shumë aksidente me fëmijë të vegjël: “... ra në zjarr me fëmijën dhe një enë e mbushur me gjellë që ishte në zjarr u thye dhe e dogji fëmijën ... kështu që fëmija vdiq pas 12 ditësh”.¹³

Fëmijët janë shpesh edhe viktimë e dhunës së të rriturve që i rrahin ata aq shumë saqë u shkaktojnë vdekjen. Kështu një fëmijë dhjetë-vjeçar që rrihet nga një i afërm që gjoja po e edukon bërtet *ve ve, quam acriter me, avuncule, leditis* (Ou, ou, sa shumë po më rrihni, o xhaxhi). Po kështu, një vajzë shtatë-vjeçare vdes nga të rrahurat e babait, sepse një natë ai e

¹³ *Repertorium Poenitentiarie Germanicum [RPG], Verzeichnis der in den Supplikenregistern der Pönitentiarie vorkommenden Personen, Kirchen und Orte des Deutschen Reiches*, hg. vom deutschen Historischen Institut in Rom, vol. I: Eugen IV (1431-1447). Edituar nga H. Schneider-Schmugge, dhe Ludwig Schmugge (Tübingen, 1998), 735; RPG VIII 3333.

urdhëroi atë të këndonte, por ajo nuk donte. I nxehur për këtë, ai e qëllloi atë me shkopin e fshesës, dhe me pëllëmbë derisa ajo ra përtokë.¹⁴

Po kështu, fëmijët janë viktimë e lojërave të dhunshme me moshatarët e tyre. Një fëmijë kujton se kur ishte nëntë vjeç, dhe po luante me një moshatar në një urë, u ngjit te zinxhiri i urës, e cila u ngrit lart dhe pastaj ra me gjithë peshën e saj mbi kokën e djalit tjetër që vdiq menjëherë.¹⁵ Një djalë tjetër kërcen mbrapsht duke bërë salto mbi tre shokët e tij të shkollës, që ishin kapur përkrahësh. Ata u rrëzuan dhe njëri u plagos kaq shumë sa vdiq pas tetë ditësh.¹⁶

Megjithatë ka edhe raste, kur nënës i vdes foshnja natën në gjumë, dhe ajo vërtet mund të ketë qenë e pafajshme për këtë tragjedi. E megjithatë, për shkak se foshnja ka vdekur natën në krevat, nëna konsiderohet fajtores, automatikisht kriminele dhe e shkishëruar, derisa të marrë falje nga Penitencieria Apostolike. Raste të tilla i kemi të regjistruara edhe në territoret shqiptare, madje që nga viti 1200, por në atë kohë ato faleshin nga autoritetet kishtarë që operonin në vend. Kështu p.sh. në dhjetor të vitit 1200, Papa Inocent III e “lejon Arqidiakonin e Durrësit të shfajësojë klerikët që janë subjekte të tij me vendosjen e duarve, si dhe gratë, fëmijët e të cilave janë gjetur të vdekur pranë tyre dhe të mos shugurojë asnjë nga subjektet e tij pa qenë ata vetë prezentë”.¹⁷

Vendime jete në moshë të papjekur

Në regjistrat e Penitencierisë, ka shumë raste të vendimeve të rëndësishme për jetën që janë marrë në moshën e fëmijërisë, si p.sh. vendimi për t’u futur në manastir, për t’u martuar në moshë të re, për ta ndarë pasurinë e tij në mes të vëllezërve etj. I tillë është rasti i një të riu, i cili donte të largohej nga kjo botë (*volens mutare vital suam et seculum omnino postponere*), prandaj pasi ua ndau të gjithë pasurinë e tij vëllezërve u fut në manastir. Problemet e tij filluan kur abati nuk e pranoi

¹⁴ RPG I, 474; IV 1423.

¹⁵ RPG VI, 3543.

¹⁶ RPG I, 528;

¹⁷ *Acta et diplomata res Albaniae mediae aetatis illustrantia* edited by Ludovicus Thallóczy, Constantinus Jireček and Emilianus Sufflay (Vienna: Typis Adolphi Holzhausen, 1913) (henceforth: *Acta Albaniae I*): 126. Innocentius III papa “archidiacono Duracii concedit, ut clericos sibi subiectos super manuum iniunctione, et mulieres, quae iuxta se suos pueros invenerunt oppressos, possit absolvere et quod nullus eius subditos sine eius presentatione presumat ordinare.” *Ex rubricis, regestri Innocentii III an. 3. Deperditi* (cd. Hampe, Mitteil. Instit. Österr. Geschichtsf. 23 [1902], 547).

betimin e tij, pra nuk e lejoi që ai të bëhej murg, e kështu ai duhet të kthehej përsëri në botën laike, por tashmë pa pasur asnjë pronë të tijën.¹⁸

Martesat dhe parregullsitë e tyre

Kategoria e *De matrimonialibus* përfshin kërkesa që kanë lidhje me martesat. Kisha Katolike e konsideronte martesën kaq të rëndësishme saqë shqyrtimi i çështjeve që kishin lidhje me të i ishin rezervuar vetë autoritetit papnor. Arsyeja ishte se duke ndjekur apostullin Pal, martesa e krishterë midis një burri dhe një gruaje ishin imazhi i gjallë i bashkimit të pandashëm midis Krishtit dhe kishës.¹⁹ Penitenciera mund të jepte dispensa dhe shpengime të çifteve që dëshironin të martoheshin ose në raste kur ishin tashmë të martuar të qëndronin në martesë me dikë me të cilin ishin të lidhur në një mënyrë të ndaluar. Penitenciera Apostolike nuk ishte zyra e vetme papnore që merrej me raste të tilla. Edhe Kancelaria papnore ashtu si dhe Dataria Apostolike mund të jepnin mëshirë të njëjtë, pa llogaritur këtu edhe legatët papnorë si dhe kolektorët, e madje ndonjëherë edhe ipeshkvët vendorë që shpesh posedonin autoritete të ngjashme.

Sipas Kishës Katolike, principi më i rëndësishëm për një martesë të vlefshme ligjore ishte që të dy partnerët të hynin në martesë me dëshirën e tyre të lirë. Nëse jo, Kisha nuk e konsideronte të vlefshëm bashkimin e tyre. Përveç kësaj, E Drejta Kanonike e kishte paraparë vlefshmërinë e martesës të rregulluar në shumë mënyra të tjera, që sigurisht vinte në pah edhe pengesat që e ndalonin një çift të ishte ligjërisht i martuar. Disa prej këtyre pengesave mund të kapërceheshin me dispensë papnore, por disa të tjera jo. Megjithëse martesa njihej zyrtarisht si një ndër shtatë sakramentet e Shenjta të Kishë Katolike që prej vitit 1274, në Koncilin II të Lionit, çështjet martesore kanë qenë subjekt i shumë diskutimeve të etërve të Kishës dhe të papëve shumë më herët. Papa Aleksandër II (1159-1181) dhe Papa Inocent III (1198-1216), kishin shpallur rregulla të rëndësishme për martesën, por vendimet më të rëndësishme legjislative u morën nga Koncili Lateran IV në vitin 1215.²⁰ Pengesa më e shpeshtë martesore ishte farefisnia apo afërsia e madhe në gjak, konsanguiniteti (*consanguinitas*). Kjo pengesë vlente për të gjitha

¹⁸ RPG VI 3754

¹⁹ Bibla, Efesianët 5:21-33.

²⁰ Nenet 50-51 të këtij koncili janë edituar në COD, f. 257-258.

çiftet që ishin të një gjaku deri në shkallën e katërt të farefisnisë.²¹ Martesat midis vëllezërve e motrave, kushërinjve të parë, të dytë si dhe kushërinjve të tretë në linjë vertikale apo horizontale konsideroheshin ilegale. Pengesa e gjakut ishte e kapërcyeshme në linjë horizontale, por jo në linjë vertikale, d.m.th. midis prindërve e fëmijëve, apo midis gjyshërve e nipave.²² Afërsia (*affinitas*) ishte një tjetër pengesë e përbashkët martesore. Ajo nuk i lejonte personat që të martoheshin me dikë që ishte kushëri i afërt në gjak me gruan e tij apo burrin e saj të parë dhe madje as me të dashurin apo respektivisht të dashurën. Ky rregull aplikohet për të afërmit në shkallë të katërt e më afër.²³ Edhe pengesa e afërsisë, ashtu si edhe ajo e konsanguinitetit ishte e kapërcyeshme.²⁴

Pengesa e tretë, mungesa e sinqeritetit publik (*impedimentum publicae honestatis iustitiae*) ishte një formë e veçantë e afinitetit dhe pengonte një person nga martesa me dikë që ishte i lidhur ngushtë me të fejuarin e saj apo të fejuarin e tij të mëparshëm.²⁵ Lidhja shpirtërore (*cognatio spiritualis*) ishte pengesa e katërt dhe më e shpeshta. Lidhja shpirtërore është lidhja e formuar në sakramentin e shenjtë të pagëzimit ose të konfirmimit midis një fëmije dhe nunit të tij apo të saj. Ky rregull kishtar nuk e lejonte një fëmijë të martohet me nunin apo ndrikullën e tij, apo të afërmit e tyre, por sigurisht që edhe kjo pengesë mund të kapërcehet në raste të veçanta, duke siguruar më parë një dispensë papnore.

Penitencieria Apostolike mund të jepte çdo lloj dispense për çifte që donin të martoheshin pavarësisht nga pengesat e mësipërme. Teorikisht, çifti duhet ta kërkonte dispensën para lidhjes së martesës, sepse konsiderohet pothuajse e pamundur për t'u martuar pa dispensën, nëse kishte ndonjë lloj pengese midis tyre nga ato që u përmendën më lart. Sipas të Drejtës Kanonike, prifti famullitar e kishte për detyrë të kontrollonte, nëse çifti që vinte për t'u kurorëzuar me martesë tek ai, kishte ndonjë lidhje të ndaluar apo jo. Për më tepër, E Drejta Kanonike

²¹ Koncepti i konsanguinitetit brenda shkallës së katërt është kompleks dhe përfshin shumë mundësi të ndryshme konsanguiniteti. Në *Corpus Iuris Canonici* I, gjendet një apendiks i quajtur Arbor consanguinitatis i cili jep të gjitha kombinimet e mundshme. Shih Aemilius Friedberg *Corpus Iuris Canonici* I (Graz: Akademische Druck- u. Verlagsanstalt, 1959), cols. 1425-1426.

²² Për rregullat e të Drejtës Kanonike në lidhje me konsanguinitetin shih X 4.14.1, 8, edituar nga Friedberg, *Corpus Iuris Canonici* II, cols. 700-701, 703-704.

²³ Shkalla e afërsisë llogaritet edhe në bazë të shkallës së konsanguinitetit midis partnerit të ri dhe të vjetër. P.sh. nëse një burrë dëshironte të martohet me një grua që kishte qenë kushërirë e shkallës së katërt me gruan e tij të mëparshme, shkalla e afërsisë midis burrit dhe gruas së re me të cilën donte të martohet ishte shkallë e katërt e afërsisë.

²⁴ Për rregullat e të Drejtës Kanonike në lidhje me afinitetin shih X 4.14.1, 8, edituar nga Friedberg, *Corpus Iuris Canonici* II, cols. 700-701.

²⁵ X 4.14.1, 8, edituar nga Friedberg, *Corpus Iuris Canonici* II, cols. 662.

kërkonte që informacionet për martesë të lexoheshin me zë të lartë në famulli gjatë tri të dielave ose gjatë ditëve të festave për t'u siguruar që nuk kishte asnjë pengesë midis çiftit të ardhshëm. Nëse ndonjëri dinte ndonjë arsye se përse çifti nuk duhej të martohej, ai apo ajo duhej menjëherë të njoftonte famullitarin. Kontrolli social nëpërmjet të lexuarit ishte i rëndësishëm për të Drejtën Kanonike, dhe parashikonte që kushdo që nuk i shprehte dyshimet e tyre apo informacionet që kishte për lidhjen e çiftit, shkishërohej automatikisht, megjithëse në fund të fundit, ishte famullitari ai që kishte përgjegjësinë përfundimtare për të kontrolluar nëse ekzistonin pengesat e mundshme.

Çiftet që dëshironin të kishin lejen e një martese apostolike zakonisht ishin të motivuar nga dëshira për të siguruar një pozicion nderi të pasardhësve të tyre, gjë që bëhej duke kërkuar një legalizim special për fëmijët e tyre. Legalizimi i pozicionit të fëmijëve ishte i rëndësishëm, sepse siguronte që ata të mund të trashëgonin pa probleme qoftë pasuri, qoftë poste. Në raste të dyshimta, gjithmonë ekzistonte rreziku që kushërinjtë të cilët kërkonin të ishin vetë përfitues, të nxirrnin në ndonjë moment pretekstin e paligjshmërisë për fëmijët e çiftit që nuk kishte dispensë papnore, duke pretenduar që nuk ishin të ligjshëm, sepse nuk kishin lindur brenda shtratit martesor, e rrjedhimisht nuk mund të ishin as legjitimë për të drejtën e trashëgimisë.

Dispensat nga lindje ilegjitime

Nga gjithë bota latino-katolike e Perëndimit, na kanë arritur rreth 38 000 raste të njerëzve që iu drejtuan Penitencierisë për dispensë nga lindje ilegjitime gjatë viteve 1449-1533.²⁶ Të dhënat kryesore për këta persona, gjenden vetëm në foliot e regjistrave të Penitencierisë, sepse shumë pak letra origjinale janë ruajtur deri sot. Arsyeja pse nuk ruheshin dokumentet origjinale, ka të bëjë më shumë me humbjen e vlerës së kësaj dispense. Kështu p.sh. kur kandidati për prift që e kishte bërë kërkesën për dispensë ilegjitimiteti ndërronte jetë, nuk kishte më arsye për ta ruajtur atë dokument. Dispensat matrimoniale, nga ana tjetër, ishin të rëndësishme edhe për pjesëtarët e tjerë të familjes, prandaj edhe ruheshin brez pas brezi.

Ekzistojnë dy lloj dispensash për sa i përket vendimeve të Penitencierisë për çështje të ilegjitimitetit: dispensat nga ilegjitimiteti në formë të thjeshtë, dhe dispensa në formën *ubi pater*. Forma e parë, kopje e

²⁶ Salonen and Schmugge, *A Sip from the "Well of Grace"*, 126.

shkurtuar e peticionit, regjistrohej në regjistrat e Penitencierisë, kurse letra origjinale e Penitencierisë, në të cilën shkruhej e gjithë formula e plotë e këtij lloji dokumenti, dërgohej te i interesuari, dhe disa prej tyre mund të gjenden akoma në arkivat vendorë. Për fat të keq, ne tani për tani kemi vetëm dokumentet e formës së parë, të ruajtura në regjistrat e Penitencierisë Apostolike, dhe akoma nuk kemi gjetur dokumente të plota që mund të ruhen në arkivat e shtetit apo gjetkë.

Nga territoret shqiptare kemi një rast nga dioqeza e Vregut, që vjen nga 29 korriku i vitit 1465. Sipas këtij rasti, Nikolla, i biri i *Urse Clebanarie*, klerik i dioqezës së Vregut, ishte nga prindër të pamartuar, prandaj kërkon që pavarësisht nga defekti [i lindjes] të promovohet me të gjitha urdhrat e shenjta dhe benefitet kishtarë si dhe me kujdes baritor vjetor. Kjo kërkesë plotësohet nga Penitencieria Apostolike nëpërmjet një mandati special, e firmosur nga abati i Shën Sebastianit, regjent.²⁷

Një rast i ngjashëm vjen edhe nga dioqeza e Kunavisë. Ast Zuri nga Latesio (!), prift i dioqezës së Kunavisë ishte biri i një prifti dhe një vajze të pamartuar. Ai kishte heshtur për këtë parregullsi dhe kishte arritur të promovohet në të gjitha urdhrat dhe të shërbente në to. Duke e ndërë veten fajtor për këtë, ose ndoshta sepse dikush ka folur për këtë të kaluar të tij, ai kërkon të lirohet nga këto parregullsi, në mënyrë që të mund të shërbejë në karrierën që ka zgjedhur. Licença jepet me një leje speciale nga Filipi, dhe shoqërohet nga kryepeshkvi i Durrësit ose vikari i tij në dioqezën e tij, ku synon të qëndrojë edhe në të ardhmen.²⁸

Rasti i parë i dokumentuar i abortit në trojet shqiptare

Thyerja e rregullave të *celibacisë* ose thyerja e normave seksuale të Kishës bëri që disa të kërkonin falje nga Penitencieria. Sipas neneve 6 dhe 7 të Koncilit II Lateran, të gjithë klerikët e shuguruar në Urdhrat e Shenjtë (subdiakon, diakon dhe priftërinj, ipeshkvë, kryepeshkvë), si dhe të gjithë

²⁷ ASV, *Penitenzieria Ap., Reg. Matrim. et Div., vol. 12, fol. 160r*. Dokument i pabotuar: *Nicolaus, filius Urse Clebanarie, clericus Veglensis diocesis de soluto genitus et soluta, petit ut non obstante defectu [natalium] ad omnes sacros ordines promoveri et beneficium ecclesiasticum etiam si curam habeat annuari obtinere possit. Fiat de speciali, abbas Sancti Sebastiani Regens etc.*

²⁸ ASV, *Penitenzieria Ap., Reg. Matrim. et Div., vol. 12, fol. 157r*. Dokument i pabotuar: *Astii Zurii de Latesio, presbyteri Conaviensi diocesis, de presbytero et soluta genitus, qui tacito defectu se fecit alias tamen rite ad omnes ordines promoveri et in ipsis ministravit quare petit absolui ab excessibus huiusmodi et quod possit ministrare in suos susceptos ordines et beneficium cum cura vel sine cura obtinere possit dispensare. Fiat de speciali. Philippus Et comitatur Archiepiscopo Duracensis vel eius vicario in cuidem diocesis ad presens moram trahit et in futurum moram trahere intendit. Fiat Philippus*

murgjit dhe murgeshat ishin të detyruar të mbanin celibacinë.²⁹ Nëse nuk u përmbaheshin këtyre neneve, disa priftërinj, murgj dhe murgesha që kishin marrëdhënie seksuale, mund të ç kishëroheshin nga ipeshkvi apo abati i manastirit, edhe pse jo drejtpërdrejt nga papa. Në mënyrë që ata që kishin thyer celibacinë të mund të vazhdonin jetën e tyre kishtare duhet të faleshin nga mëkati që kishin bërë, gjë që mund ta bënte edhe ipeshkvi vendor. E megjithatë shumë prej fajtorëve i drejtoheshin Penitencierisë për falje. Në rastin tonë, prifti nga Polati i Poshtëm, në fakt, nuk e vë në rend të parë thyerjen e celibacisë, por pasojat e një veprimi të tillë.

Në dokumentin që po japim më poshtë, prifti nga Polati i Poshtëm, me emrin latin Mikeli Nikolla, [*Michael Nicolai* = Mikel Nikolla] që në shqip do të ishte Mikeli i Nikollës siç do ta shpjegojmë më poshtë, kërkon një letër deklarative nga Penitencieria Apostolike për të provuar pafajësinë e tij në abortet e një gruaje shtatzënë. Si zakonisht, letrat deklarative janë shumë të detajuara, sepse kërkohet që ngjarja të jetë sa më e detajuar dhe e saktë, duke qenë se gjithçka që përmendet në letër do të kontrollohet për vërtetësinë e saj, nga e cila varet edhe dhënia e fajësisë apo pafajësisë. Në rastin tonë, Mikeli rrëfen për një marrëdhënie intime me një grua të pamartuar, marrëdhënie kjo e cila ka vazhduar për një kohë relativisht të gjatë dhe që ka rezultuar me shtatzëninë e gruas. Duke qenë se të dy patën frikë nga skandali që mund të shkaktohej po të merrej vesh historia e tyre e pshore, si dhe duke pasur frikë për rrezikun që i kanosej personit të tyre, *personarum suarum periculum*, vendosën që gjithçka ta mbajnë të fshehur. Ja përmbajtja e plotë e dokumentit:

Mikeli i Nikollës, prift i dioqezës së Pulti i Poshtëm, i cili dikur i udhëhequr nga epshi, pati marrëdhënie karnale shumë herë me një grua të pamartuar, saqë ajo mbeti shtatzënë. Kur eksponenti i përmendur deshi ta dërgojë atë në një vend tjetër për shkak të skandalit që mund të shpërthente prej kësaj dhe rrezikut për personin e tij dhe të vetë gruas, ajo nuk e deshi këtë, vetë eksponenti nxiti atë të sillet aq fshehurazi sa që kjo lindje të mos binte kurrë në sy të askujt, gjë që gruaja e bëri ashtu. Por më pas shpjguesi raportoi se ai kishte përsëri marrëdhënie karnale me këtë grua disa herë, dhe ajo përsëri mbeti shtatzënë, dhe eksponenti përsëri e këshillon atë që të sillet me aq kujdes dhe fshehurazi sa që vepra e tyre të mos zbulohet kurrë, dhe pastaj gruaja lindi.

²⁹ Nenet 6 dhe 8 janë edituar në COD, f. 174. Në lidhje me Penitencierinë dhe krimet seksuale shih Schmutge, Hersperger dhe Wiggenhauser 1996, f. 147-151 dhe Salonen 2001, f. 157-159.

Por, kur eksponenti në fjalë e pyet me kujdes gruan se çfarë kishte bërë me shtatzënitë dhe nëse i kishte helmuar fetuset në mitër apo jo, gruaja nuk i tregoi asgjë për rrethanat /107^v/ nga dëshira për të qenë krejtësisht e fshehtë që të mund të shërbente me zjarr të madh përkushtimi në të gjitha urdhrat më të larta të famullitarit. Megjithatë ai dyshon që disa gjëra kanë rënë në sy të disa të tjerëve të thjeshtë dhe që s'e njohin ligjin, dhe ndoshta ata pohojnë që eksponenti ka kryer vrasjet e përmendura me paramendim dhe se ai ka rënë në parregullsi dhe ilegjitimitet dhe se për këtë arsye nuk është në gjendje të shërbejë në postin e tij. Për të penguar gojën e atyre që të flasin tani dhe në të ardhmen, i lutet Shenjtërisë Suaj, duke shpjeguar atë që ai tha, në masën që ai vetë nuk ka kryer ndonjë krim vrasjeje dhe nuk ka rënë në asnjë parregullsi apo paaftësi për shkak të rrethanave, por megjithatë ka premtuar se do të rrëfëhet që të mund të shërbejë në mënyrë të ligjshme për të gjitha ofiqet e tij, siç duhet.

Le ta shohë z. Anton de Grassi Philippi.

Le të angazhohet ordinari dhe nëse nga pyetjet rezulton se rrethanat janë të vërteta dhe që eksponentit nuk i është dhënë shkak i abortit, të deklarohet siç ka kërkuar.

Romë, 15 mars 1467.³⁰

³⁰ ASV, Penitenzieria Ap., Reg. Matrim. et Div., vol. 14, fol. 107r-v. Michael Nicolai presbyter Polatensis Minoris diocesis, quod ipse olim spiritu libidinis ductus quadam mulierem solutam pluris actu fornicationis carnaliter cognovit quam propter ea impregnata. Cum dictus exponens ad aliam patriam ducere vellet propter scandalum quod inde oriri posset et personarum suarum periculum et ipsa mulier id facere nolet, ipse exponens eam ortatus est ut ita secrete se gereret quod partus iste ad nullius noticiam umquam devenire posset quod quid mulier ita sic fecisse retulit deinde vero ipse exponens eandem mulierem pluries carnaliter cognovit que similiter impregnata extitit quam cum ut prius ipse exponens monuisset ut eciam ita caute et secrete se gereret quod eorum facta nunquam detegerentur ipsa mulier postea peperit. Cum autem dictus exponens ab eadem muliere diligenter perscrutatus fuerit qualiter ut quinam premissa fecerit et an fetus in utero fuissent veneficati vel non et a dicta muliere nichil scire potuit ^{/107^v/} de premissis ut hoc penitus sit occultum cupiatque ex magno devotionis fervore in omnibus suis ordinibus perpetuo altissimo famulari, dubitat tamen si ad noticiam devenerit aliquorum ab eisdem tamquam simplicibus et iuris ignaris ac ipsius exponentis forsan emulis asserunt ipsum occasionem premissorum homicidiorum reatus incurrisse et irregularitatis seu inhabilitatis illicitis maculam sive notam contraxisse et propter ea in suis ordinibus ministrare non posse ad obstruendum igitur ora eorum ut aliorum sibi super hoc in futuris forsan obloqui volentium emulorum supplicat, sanctitati vestre, dictus exponens, quatenus ipsum nullum homicidii reatum incurrisse, nullamque irregularitatis sive inhabilitatis maculam sive notam propter premissa contraxisse, sed ipsum non obstante promisset in omnibus suis ordinibus licite ministrare posse dignemini declarari mandare ut in forma. Fiat ut infra, Philippus sancti Laurentii in Lucina. Videat eam dominus Anth. de Grassis Phi. Comittatur ordinario et si vocatis vocandis premissa vera esse invenerit et quod exponens abortioni causam non dederit declaretur ut petitur. Rome, idus martii 1467

Ky është një ndër raste më spektakolare dhe njëkohësisht edhe më interesante të mesjetës shqiptare. Bën fjalë për një histori të jashtëzakonshme të Shqipërisë së shekullit të pesëmbëdhjetë. Historia tregohet nga një prift dhe është regjistruar si suplikë më 15 mars të vitit 1467 në Arkivin e Penitencierisë së Shenjtë Apostolike.³¹ Duke qenë se prifti nuk e konsideron veten fajtor, por shkruan që të tjerët e akuzojnë për një gjë që ai nuk e shikon veten fajtor, falja nuk jepet automatikisht në këto raste, por dërgohet për shqyrtim të mëtejshëm. Këto raste janë edhe më interesantët, në fakt, sepse ndryshe nga rastet, kur fajtori pranon fajin dhe nuk jep shumë detaje, këtu petenti duhet ta tregojë ngjarjen me shumë hollësi, në mënyrë që të besohet që ai vërtet nuk është fajtor. Një letër e tillë, zakonisht ruhej në kategorinë *de declaratoriiis*.

Letra është shkruar nga prifti Mikeli Nikolla (*Michael Nicolai*) ose më saktë Mikeli i Nikollës, sepse Nicolai është rasa gjinore e emrit Nicolaus dhe në mesjetë, fenomeni i të shkruarit të emrit të babait në vend të mbiemrit është mjaft i përhapur ndër shqiptarët. Mikeli i Nikollës është nga dioqeza e Pultit të Poshtëm,³² ipeshkvin e të cilit Eubeli e identifikon vetëm si Nikolla.³³ Nuk përjashtohet mundësia që Nikolla është person tjetër, sepse Mikeli quhet thjesht prift në dokumentin në fjalë, megjithëse është pak e pamundur që një vend kaq i poshtëm sa Pulti i Poshtëm të kishte edhe prift edhe ipeshkv. Mikeli kërkon nga Penitenciera Apostolike të shpallet i pafajshëm për krimin e abortit, apo të vrasjes, të cilin ai pretendon se as nuk e ka bërë, dhe as nuk ka gisht në të.

Historia e treguar nga Mikeli duket shumë e singertë, por ka edhe nota që janë të njohura si formula të rasteve të tilla, si p.sh. përmendja e frymës së lakmisë: Mikeli Nikolla, prift i dioqezës së Pultit, dikur i shtyrë nga lakmia pati marrëdhënie seksuale më një grua, e cila nuk ishte e martuar. Fakti që këto marrëdhënie seksuale, në fakt, i pati shumë herë (*pluris actu fornicationis*), tregojnë që nuk ka qenë rastësi apo paafësi për

³¹ ASV, *Penitenzieria Ap., Reg. Matrim. et Div.*, vol. 14, fol. 107r-v.

³² See Eubel, *Hierarchia Catholica* vol. II, 217. [Conradum Eubel, *Hierarchia Catholica medii aevi sive summorum pontificum, S. R. E. Cardinalium, ecclesiarum antistitum series ab anno 1431 usque ad annum 1503 perducta e documentis tabularii praesertim Vaticani collecta, digesta*, edita per Conradum Eubel, S. Theol. Doct. Ord. Min. Conv. Definitorem generalem olim Apostolicum apud S. Petrum de urbe poenitentiarium. Editio Altera. Monasterii, Sumptibus et typis Librariae Rensbergianae, MDCCCXIV, vëll. II, f. 217.] [P. Pius Bonifacius Gams, *Series episcoporum ecclesiae catholicae, quotquot innotuerunt a beato Petro Apostolo. A multis adjunctus* edidit P. Pius Bonifacius Gams, O.S.B. Graz, Akademische Druck und Verlagsanstalt, 1957, f. 413.]

³³ Nikolla ishte ipeshkv i Pultit nga viti 1454 deri në vitin 1470, kur ka vdekur. Shih Eubel, *Hierarchia Catholica* vol. II, 217.

të kontrolluar veten në një moment të caktuar, por ka qenë një histori e gjatë, të cilën ai e nxjerr në pah vetëm kur rrezikohet nga të tjerët.

Kur gruaja mbeti shtatzënë, ai madje ka thurur edhe plane: i ka thënë asaj që ta nxirrte jashtë vendit, për shkak të skandalit që mund të shpërthente nga kjo, dhe gjithashtu për shkak të rrezikut që u kanosej jetëve të tyre (*propter scandalum quod inde oriri posset et personarum suarum periculum*). Duke qenë se gruaja nuk donte (*ipsa mulier id facere nolet*) të shkonte jashtë vendit, ai e inkurajoi atë që të sillej në mënyrë kaq sekrete, sa që lindja të mos i binte në sy askujt (*ipse exponens eam ortatus est ut ita secrete se gereret quid partus iste ad nullius noticiam devenire posset*). Gruaja veproi pikërisht ashtu (*quod quid mulier ita sic fecisse*) dhe askush nuk e mori vesh.

Historia nuk mbaroi me shtatzëninë e parë. Ata vazhduan të kenë marrëdhënie seksuale dhe gruaja përsëri mbeti shtatzënë. Kuptohet që Mikeli i sugjeroi të njëjtën gjë si herën e parë: të ishte e kujdesshme dhe ta mbante atë sekret (*ut etiam ita caute et secrete se gereret*). Por këtë radhë gruaja lindi (*ipsa mulier postea peperit*), dhe kur lindi, ai filloi të dinte detajet, se çfarë ndodhi me beben që lindi, sepse ai di që foshnja ka lindur e vdekur, por nuk di detajet (*an fetus in utero fuissent veneficati vel non et a dicta muliere nichil scire potuit*).

Në suplikë, Mikeli flet për akuza për *infanticidium*, por nuk tregon me saktësi se kush janë akuzuesit. Ne mendojmë që akuzuesit duhet të jenë të afërmit e vajzës, sepse kjo është mënyrë e vetme sesi ata mund të hakmerren ndaj një prifti. Duke u akuzuar për vrasje, Mikeli kishte rënë automatikisht në shkishërim, dhe vetëm në këtë mënyrë mund të humbte statusin si prift i Pultit të Poshtëm, si dhe benefitet dhe privilegjet që lidheshin me atë status, ndër të cilat kryesori në këtë rast ishte paprekshmëria e priftit. Duke qenë i shkishëruar, familja e vajzës mund edhe ta vriste Mikelin, sipas kanunit të Lekë Dukagjinit, sepse nuk ishte më prift, pra nuk ishte më i mbrojtur nga E Drejta Kanonike. Kjo është arsyeja se përse Mikeli përmend rrezikun që i kanosej si atij ashtu edhe vajzës.

Sigurisht që edhe vajza ishte e kërcënuar nga familja e saj, sepse vajzat që thyenin rregullat e abstinencës seksuale para martesës, ishin të destinuara që të tërhiqnin një varg dënimesh të familjes dhe të fisit.³⁴ Sipas

³⁴ [Shtjefën Konst. Gjeçovi, *Kanuni i Lekë Dukagjinit. (Vepër postume). Përmbledhë e kodifikue prej A. Shtjefën Konst. Gjeçov. O. F. M. Me parathënë t'A. Gjergj Fishtës O.F.M. e biografi t'A. Pashk Bardhit O.F.M. Shkodër, Shtypshkronja Françeskane, 1933.] Kanuni i Skanderbegut, ed. Dom Frano Illia (Milot: Editrice La Rosa, 1993), 208. [Dom Frano Illia, *Kanuni i Skanderbegut*.*

Kanunit të Lekë Dukagjinit, imoraliteti dënohej me ekzekutimin e të dyve: edhe të djalit edhe të vajzës.³⁵ Kjo ishte arsyeja se përse Mikeli Nikolla i kërkon vajzës që ta nxirrte jashtë vendit (*ad aliam patriam ducere vellet*). Shtatzënia e saj ishte e destinuar të shkaktonte skandal, nëse do të vihej re (*propter scandalum quod inde oriri posset*), dhe skandali do të vinte në rrezik jetën e të dyve (*et personarum suarum periculum*), një frikë mjaft e arsyeshme po të mbajmë parasysh kanunin.

Me qëllim që të kthehej në postin e tij, dhe t'i rifitonte ato, duhet patjetër të merrte një deklaratë pafajësie nga Selia e Shenjtë. Për këtë arsye, ai përdor një fjalor mjaft të zgjedhur dhe të devotshëm, kur përshkruan rastin e tij: *ex magno devotionis fervore in omnibus suis ordinibus perpetuo altissimo famulari* (nga një zjarr i madh përkushtimi në të gjitha shkallët e tij për të shërbyer vazhdimisht në shkallën më të lartë). Nuk e dimë në fakt, nëse këto janë fjalët e tij personale, apo të atij që e ka ndihmuar ta shkruajë suplikën sipas standardeve të pritshme dhe të pëlqyeshme për Penitencierinë e Shenjtë. Këto zakonisht shkruheshin nga një prokurator, i cili ishte i specializuar për të tilla shkrime dhe paguhej ekskluzivisht për këtë punë. Megjithatë, fakti që në letër ka shumë detaje që nuk janë standarde në letrat e tjera të ngjashme, tregon që vetë prifti duhet të ketë qenë në Romë personalisht për këtë çështje.

Duke qenë se Mikeli ishte i akuzuar për vrasje (*homicidium*) dhe madje jo një, por më shumë se një (*homicidiorum reatus*), dhe për më tepër nuk pranonte të ishte fajtor, ai jo vetëm që nuk mundej të shërbente si prift (*propter ea in suis ordinibus ministrare non posse*), por çështja duhej të investigohej në terren nga një *ordinarius*, i cili do të duhej të pyeste dëshmitarët dhe të gjente të vërtetën. Sigurisht që kjo histori është shumë e komplikuar dhe përmban shumë pikëpyetje ku mund të angazhohen studiues të fushave të ndryshme.

Fjala *olim* (dikur) dhe i gjithë procesi i përshkruar nga prifti tregon për një rast të përsëritur, i cili ngre shumë pyetje në lidhje me jetën e përditshme në këto zona në mesjetën e vonë. Nëse kemi parasysh që Pulti i Poshtëm është në veri të Shqipërisë, çështja shtrohet se çfarë roli ka luajtur koncepti i nderit dhe i humbjes së nderit, kur prifti shkruan për rrezikun që u kërcënohet jetëve të tyre. Duke qenë se Kanuni i Lekë Dukagjinit,³⁶ ekzistonte që në antikitet,³⁷ ai sigurisht që rregullonte edhe jetën e priftit

Mbledhë e kodifikue nga Dom Frano Illia. Brescia – Italy, Editrice La Rosa, 1993, 208.] Raste të tilla vrasjeje kishte plot edhe në Dubrovnik. Shih Nella Lonza, "Two Souls Lost", 79.

³⁵ *Ibid.*, *Kanuni i Lekë Dukagjinit*, 10, art. 22, no. 824.

³⁶ Gjeçovi, *Kanuni i Lekë Dukagjinit*, libër i parë: "Kisha," f. 1-6.

³⁷ Robert Elsie, *Historical Dictionary of Albania. European Historical Dictionaries No. 42*

dhe marrëdhëniet e tij me të tjerët. Një vajzë shtatzënë sigurisht që ishte e patolerueshme për familjen, por nga ana tjetër, prifti ishte i paprekshëm, për shkak të pozicionit që kishte. Marrëdhëniet seksuale ishin mëkat që mund të faleshin edhe nga kryeipeshkvi apo legati papnor, kështu që familja e vajzës nuk kishte të drejtë t'i bënte asgjë priftit, për sa kohë që ai ishte prift.³⁸ Çështja ndryshonte po të ishte i akuzuar për vrasje, siç konsiderohej rasti i abortit. Duke e akuzuar priftin direkt apo indirekt nëpërmjet thashethemeve për vrasje, prifti humbte automatikisht pozicionin e tij, dhe jo vetëm që nuk mund të ushtronte detyrat e tij si prift, por edhe nuk ishte më i paprekshëm, por i rrezikuar nga familja e vajzës.

Po të analizojmë vendin, që Mikeli kishte parasysh, kur i propozoi vajzës ta dërgonte në vend tjetër (*ad aliam patriam ducere vellet*), variant më i mundshëm duhet të ketë qenë Raguza (sot Dubrovniku). Raguza ishte jo vetëm qyteti që kishte më shumë shqiptarë se çdo qytet tjetër joshqiptar, por priftërinjtë kishin lidhje shumë të mira me njëri-tjetrin. Përveç kësaj, Republika e Raguzës ishte e famshme për organizimin shumë të mirë social dhe për spitalet e shumta në mesjetë, një ndër të cilët ishte edhe *hospital dela misericordia*, ku pranoheshin fëmijët e braktisur që pastaj merreshin nga manastiri Shën Klarës.³⁹ Ky spital ekzistonte që nga fundi i shekullit të trembëdhjetë. Një variant tjetër mund të ketë qenë edhe Firence, por që kërkonte më shumë përgatitje logjistike.⁴⁰ Fakti që vajza nuk pranoi të shkonte jashtë vendit është i pazakontë, po të kemi parasysh rrezikun që i kanoset jetës së saj. Marrja përsipër e një rreziku të tillë, na bën të mendojmë që ajo kishte besim te ndihma e një personi vendor për ta zgjidhur situatën. Përveç kësaj, ndoshta ajo ka besuar edhe në pranimin e heshtur të situates së saj nga e gjithë familja, “ku e gjithë familja e ndihmon gruan të heqë fëmijën e padëshiruar dhe t'i shpëtojë rrezikut të stigmatizimit”.⁴¹ Prifti mesa duket, kishte gjithashtu dijeni për këtë solidaritet apo person, dhe kjo duket nga inkurajimi që i jep vajzës për të qenë e kujdesshme dhe për ta mbajtur sekret që shtatzënia të mos bjerë në sy (*ipse exponens eam ortatus est ut ita, secreta se gereret quid partus iste*

(Lanham, Maryland, and Oxford: The Scarecrow Press, Inc, 2004, 217.

³⁸ Gjeçovi, *Kanuni*, libër 10, krye 22, nr. 81-82.

³⁹ Nella Lonza, “‘Two Souls Lost’: Infanticide in the Republic of Dubrovnik (1667-1808)”. *Dubrovnik Annals* 6 (2002): 76, note 40.

⁴⁰ Richard Trexler, “The foundlings of Florence, 1395-1455” *History of Childhood Quarterly* I (1973-1974). [Richard Trexler, “The foundlings of Florence, 1395-1455” *History of Childhood Quarterly: The Journal of Psychohistory*. I. New York, Atcom Inc., 1973, vëll. 1, nr. 1, 2, 3, f. 259-284.]

⁴¹ Nella Lonza, “Two Souls Lost”, 84.

ad nullius noticiam devenire posset) dhe vajza kështu bëri (*quod quid mulier ita sic fecisse*).

Edhe pse nga fjalët e priftit nuk del qartë, nëse fëmija i lindur ka genë i gjallë apo i vdekur, vendimi i Penitencierisë Apostolike në fund të dokumentit, e bën rastin shumë të qartë: *abortioni causa*. Kjo na bën të shqyrtojmë dijen dhe praktikën që ekzistonin në mesjetë për abortin në territoret shqiptare, por që nga ky dokument nuk mund të nxjerrim shumë të dhëna për këtë. Po të kemi parasysh që Shqipëria ishte kaq mirë e lidhur me vendet e tjera, sa ç' duket në këtë dokument, sigurisht që edhe dija dhe praktikën abortuese duhet të kenë qarkulluar bashkë me dije dhe praktika të tjera, që ishin të përhapura në të gjithë Evropën.⁴² Raguza kishte tashmë praktikën të institucionalizuar për këtë.⁴³

Ky dokument sjell në vëmendje në mënyrë të paprecedentë marrëdhënien që kishin dy sistemet juridike me njëri-tjetrin në trojet shqiptare: nga njëra anë E Drejta Kanonike dhe nga ana tjetër Kanuni i Lekë Dukagjinit. Nga mënyra sesi është shtruar çështja nga prifti, duket qartë që jo vetëm prifti njih mirë të dyja këto ligje, dhe ndoshta edhe i shfrytëzon qëllimisht ato deri në ekstremitet, por edhe populli, në këtë rast familja e vajzës, i njih shumë mirë të dyja këto ligje, sepse e dinë që edhe pse priftin nuk mund ta dëmtojnë për marrëdhëniet seksuale, ku ai ndoshta është edhe abuzues, ai lehtësisht mund të sulmohet me akuza për *homicidium* dhe të humbë privilegjet dhe mbrojtjen që i ofron E Drejta Kanonike dhe statusi i tij si prift. Në këtë kontekst, deklarata e pafajësisë për priftin është një çështje jete a vdekje. Nëse do të merrte këtë letër pafajësie, ai do ta paraqiste atë në Pultin e Poshtëm dhe duke rifituar përsëri të drejtat si prift, do të ishte përsëri i paprekshëm si më parë.⁴⁴

⁴² John M. Riddle, *Eve's Herbs: A History of Contraception and Abortion in the West* (Cambridge: Harvard University Press, 1997). Keith Wrigton "Infanticide in European History" *Criminal Justice History* I (1982): 6, Sylvie Laurent, *Naitre au Moyen Age. De la conception a la naissance: la grossesse et l'accouchement (XIIe-XVe siecle)* (Paris: Le Leopard d'Or, 1989), 159. R.M. Helmholtz, "Infanticide in the Province of Canterbury during the Fifteenth Century," *History of Childhood Quarterly* 2 (1975): 379-383.

⁴³ For a detailed account and analysis about abortion in Dubrovnik shih Nella Lonza, "'Two Souls Lost': Infanticide in the Republic of Dubrovnik (1667-1808). *Dubrovnik Annals* 6 (2002): 67-107.

⁴⁴ Jürgen Straub, ed., *Narration, Identity, and Historical Consciousness. Making Sense of History* (New York, Oxford: Berghahn Books, 2005).

SUMMARY

ETLEVA LALA

THE ARCHIVES OF THE HOLY APOSTOLIC PENITENTIARY AND A CASE OF AN ABORTION IN THE LOWER PULT

The results of archival research in the Apostolic Archives of the Vatican City for many years, especially in the Holy Apostolic Penitentiary (Sacra Poenitentiaria Apostolica), which is not so open to general public as the other parts of the Vatican Archives are, have brought extraordinary results for the recognition, functioning, scope and responsibilities that this very important institution had over the centuries. Ecclesiastical, political, institutional, military, secular, spiritual, social, family, economic history, just to name some, can be studied through these documents. Here I try to shed light on how Canon Law and traditional Albanian laws interact in certain cases in medieval Albanian territories.

The cases from the medieval Albanian territories officially presented to the Holy Penitentiary create an opportunity to assess the general social condition of the Albanian lifestyle in the fifteenth century. The publication for the first time of some documents about medieval Albanians, accompanied by the transcription of the original in Latin and the translation into Albanian, is done to enable researchers and other interested parties to closely follow not only general problems that still exist today, namely the relations between genders, between religious and secular, between norms and practices of legal codes, etc. but also a very special one, namely abortion.